VENDIM
Nr. 88, datë 29.9.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "UKKO" SHA NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA IMPIANTE FOTOVOLTAIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa "a"; 9 dhe 13 pika 1, germa "a", të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa "a"; 5 pika 1 germa "a"; 13 dhe 14 pika 1 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.9.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "UKKO" sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga impiante fotovoltaike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "UKKO" sh.a. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4.4.1 pika 4.4.2; 4.4.3) janë plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pika 4.4.4) është plotësuar pjesërisht: Mungon plani i biznesit.
- Leje nga institucione të tjera (neni 9, pika 4.4.5) është plotësuar pjesërisht: Mungon leja mjedisore nga organet përkatëse.
- Për dokumentacionet e munguara do të njoftohet subjekti që në bazë të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "UKKO" sh.a., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga impiantet fotovoltaike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit Ahmeti